

Në bazë të Nenit 39 të Ligjit për Mbrojtjen e të Drejtave të Pacientëve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 82/08, 12/09, 53/11 dhe 150/15 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 190/19 dhe 122/21 Qyteti i Shkupit publikon

**Shpallje publike
për zgjedhjen e anëtarëve të
Komisionit për avancimin e të drejtave të pacientëve**

Përshkrimi i Shpalljes publike:

Në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e të Drejtave të Pacientëve, Qyteti i Shkupit formon Komisionin e përhershëm për avancimin e të drejtave të pacientëve, në përputhje me dispozitat nga fusha e vetëqeverisjes lokale.

Shpallja publikohet për zgjedhjen e dy anëtarëve: një përfaqësues nga shoqatat që merren me të drejtat e njeriut dhe iniciativat qytetare dhe një përfaqësues mjek nga komunat.

Mandati i anëtarëve të Komisionit është 2 (dy) vjet, me të drejtë edhe të një zgjedhjeje të njëpasnjëshme.

Qyteti i Shkupit siguron mbështetje logjistike dhe mjete për punën e anëtarëve të Komisionit.

Vendimi për formimin e Komisionit për avancimin e të drejtave të pacientëve do të propozohet në seancën e Këshillit të Qytetit të Shkupit, me propozim të Komisionit për verifikim, çështje mandatesh, mirënjohje, parashtresa dhe ankesa.

E drejta për pjesëmarrje në Shpalljen publike:

1. Organizatat e shoqërisë civile që merren me të drejtat e njeriut dhe iniciativat qytetare
2. Individë, me profesion mjekë

Detyra pune të anëtarëve të Komisionit:

- Pjesëmarrje e rregullt dhe aktive në mbledhjet e Komisionit;
- Përgatitja dhe zbatimi i planit të punës së Komisionit me afat kohor;
- Përgatitja e Rregullores së punës së Komisionit si dhe akteve të tjera;
- Monitorimi dhe vlerësimi i situatës me mbrojtjen e të drejtave të pacientëve;
- Shqyrtimi i ankesave të pacientëve dhe propozimi i masave për përmirësimin e mbrojtjes së të drejtave të pacientëve tek autoritetet kompetente;
- Përgatitja dhe paraqitja e raportit për mbrojtjen e të drejtave të pacientëve para Këshillit të Qytetit të Shkupit;
- Përgatitja e informacionit, materialeve promovuese dhe të tjera për avancimin e të drejtave të pacientëve;
- Realizimi i aktiviteteve të tjera për avancimin e të drejtave të pacientëve dhe mbrojtjen e tyre;

Kritere për pjesëmarrje në Shpalljen publike:

- Arsim i lartë i përfunduar (si përparësi do të konsiderohen studimet e kryera në mjekësi, drejtësi, punë sociale, por nuk përjashtohen studimet e tjera);
- Përvojë pune në fushën përkatëse ose punën/sectorin adekuat të veprimtarisë: shëndetësi ose sektori juridik, shoqëri civile, demokratizim, të drejtat e njeriut, diversitet kulturor dhe dialog, shëndetësi, punë social-humanitare, nacionalitete, përfaqësim dhe lobim i pacientëve dhe personave të tjerë të marginalizuar;
- Pjesëmarrja në projekte që çojnë drejt:
 - avancimit të shëndetit dhe të drejtave të pacientëve;
 - promovimit të mundësive të barabarta dhe avancimit të të drejtave të njeriut;
 - reduktimit të stigmatizimit dhe diskriminimit të pacientëve;

Mënyra e aplikimit për Shpalljen publike dhe dokumentacioni i nevojshëm:

1. Organizatat joqeveritare të interesuara duhet të depozitojnë dokumentet e mëposhtme:
 - Formular me informacione për organizatën;
Shkresë nominimi nga organizata për emërimin e një personi si anëtar të Komisionit;
 - CV (biografia profesionale) e personit të kandiduar dhe fotokopja e diplomës së arsimit të kryer;
 - Dokumentacion tjetër për të cilin organizata joqeveritare beson se mbështet aplikimin dhe është në përputhje me kriteret e deklaruara për anëtar të Komisionit.
2. Personat e interesuar depozitojnë dokumentet e mëposhtme:
 - CV (biografia profesionale) dhe fotokopje e diplomës për arsimin e kryer;
 - Letër motivimi;
 - Dokumentacion tjetër që kandidati beson se e mbështet aplikimin dhe është në përputhje me kriteret e deklaruara për anëtar të Komisionit.

Vlerësimin e propozimeve të pranuara do ta bëjë Komisioni për verifikim, çështje mandatesh, mirënjohje, parashtresa dhe ankesa, i cili do të depozitojë propozim pranë Këshillit të Qytetit të Shkupit.

Afati dhe mënyra e depozitimit të aplikimeve

Afati i fundit për depozitimin e aplikimeve 10.03.2025 deri në orën 12:00.

Aplikimet me të gjithë dokumentacionin e skanuar depozitohen nëpërmjet postës elektronike në adresën: pravanapacienti@skopje.gov.mk (me shënimin në lëndën - Aplikim për shpallje).

Për informacione plotësuese:

Pyetjet për sqarime mund të parashtrohen në mënyrë elektronike në pravanapacienti@skopje.gov.mk dhe numrin e telefonit për kontakt 02/ 3297 278. Personi për kontakt Igor Stevčeski, bashkëpunëtor në Sektorin për mbrojtje sociale, të fëmijëve dhe shëndetësore, Sektori për veprimtari publike, Qyteti i Shkupit.